

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Dëshmitarët nuk shkuan në sallë të gjyqit, u pranuan 130 deklarata me shkrim", avokatja sjell detaje të f orta nga Haga - Euronews Albania
ADRESA	https://euronews.al/deshmitaret-nuk-shkuan-ne-salle-te-gjyqit-u-pranuan-130-deklarata-me-shkrim-avokatja-sjell-detaje-te-fora-nga-haga/
BURIMI	euronews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 20:11:27 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 20:07:05 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	305f5e3642949d910490b35c8b8becb81aafdedacbd23dd67ab6f561371d2215
TEKSTI	c6b9d8fcf7c2b3d32b5b9ddb03eabceabb8e86c36ae3c28c4e77266622f26883
PAMJA	888fe8dc18477032d4f61d961b44529bf93c9764f1cb6639e5dcb4b08de5e759

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	3521ffa17e327ecb3697e3844302fd7aa2bb06940c4cde340c0a44154d34b165
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	3b121f0f38f9983afad61fe399871208f196860b9a8965bfd896e6b91a545c4e
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/3521ffa17e327ecb3697e3844302fd7aa2bb06940c4cde340c0a44154d34b165>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.


Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TREND

Gjyqi i UÇK Bedri Hamza SHBA Turqi enton abilekaj

NOW ME ERLA MËHILLIN

“Dëshmitarët nuk shkuan në sallë të gjyqit, u pranuan 130 deklarata me shkrim”, avokatja sjell detaje të forta nga Haga



17 Shtator 2026 | 22:07

Rudina Jasini, ish-avokate e Hashim Thaçit, ka ndarë në emisionin “Now” në Euronews Albania detaje nga procesi gjyqësor në Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë, ndaj katër ish-drejtimesve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Jasini tha se pala mbrojtëse është përballur me një proces të vështirë, ndërsa ngriti pretendime mbi mënyrën e zhvillimit të gjykimit dhe administrimit të provave.

Sipas saj, në disa raste gjyqtarët kanë bërë pyetje përtej atyre të parashtruara nga prokuroria, ndërsa një pjesë e dokumenteve të përdorura në proces, sipas saj, janë dorëzuar nga Serbia.

“Si mundet që gjyqtarët të bëjnë pyetje që kapërcenin pyetjet e prokurorisë, në kërkim të asaj që është e vërtetë? Gjyqtari gjerman nuk ka qenë as gjyqtar në Gjermani, por ish-prokuror. Është absurde të bësh pyetje përtej asaj që kërkon prokuroria”, deklaroi Jasini.

Ajo tha gjithashtu se mbrojtja është përballur me një numër të madh juristësh nga pala e akuzës dhe se, sipas saj, mënyra e paraqitjes së çështjes nga prokuroria ka krijuar konfuzion.

“Një pjesë e dokumenteve i janë dhënë kësaj gjykate nga Serbia. Jemi përballur me një ushtri juristësh të prokurorisë, e cila që në fillim ka pasur një predispozitë të caktuar se si e ka trajtuar akuzën. Mbrojtja ka bërë maksimumin duke pasur parasysh rrethanat.

Mënyra si e ka paraqitur prokuroria ishte që një dëshmitar mund të kishte lidhje me një çështje të vitit ‘98, një tjetër brenda javës kishte të bënte me një çështje tjetër të vitit ‘99. E gjitha ishte për të krijuar sa më shumë konfuzion”, u shpreh ajo.

Një tjetër çështje e ngritur nga Jasini lidhet me dëshmitë e administruara gjatë procesit. Ajo pretendoi se mbi 130 dëshmi janë pranuar në bazë të deklaratave me shkrim, pa u dëgjuar drejtpërdrejt në sallën e gjyqit.

“Mbi 130 dëshmitarë janë pranuar vetëm mbi bazën e deklaratave me shkrim, pra pa iu testuar në sallën e gjyqit dëshmia që jepnin”, tha Jasini.

LAJMI I FUNDIT

21:58 Abilekaj: Gabuam duke i parë serbët si partnerë, vendimi Hagës na gjeti të gjithëve në faj

21:38 Haxhiu: UÇK-ja nuk mbrohet duke i shpallur kundërshtarët politikë “spiunë” e “tradhtarë”

21:34 Kundërofensiva ukrainase “shpartallon” forcat ruse

21:27 Prishtinë, protestë masive kundër vendimit të Speciales SHPËRNDAJËDaj drejtuesve të UÇK-së ARTIKULLI(VIDEO)

21:20 “Flirtet e Ramës me Vuçiçin”? Ish-ministri Vengu i përgjigjet akuzave

20:58 Hamza takon liderët e partive tjera: Diskutuam për bashkëpunim në këtë periudhë të rëndësishme

TESTIM

LAJME TË SUGJERUARA

KOSOVË | LAJMI I FUNDIT | NOW ME ERLA MËHILLIN | RAJONI

Abilekaj: Gabuam duke i parë serbët si partnerë, vendimi Hagës na gjeti të gjithëve në faj

I ftuar në “Now me Erela Mëhillin”, gazetari Enton Abilekaj komentoi vendimin e Gjykatës Speciale në Hagë për katër ish-drejtnesit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës....

21:58 | 17/09/2026

LAJM KRYESOR | NOW ME ERLA MËHILLIN

“Flirtet e Ramës me Vuçiçin”? Ish-ministri Vengu i përgjigjet akuzave

Ish-ministri i Mbrojtjes, Piro Vengu, ka komentuar në emisionin “Now” në Euronews Albania deklaratën e përbashkët të Partisë Socialiste dhe Partisë Demokratike lidhur me vendimin...

21:20 | 17/09/2026

AKTUALITET | NOW ME ERLA MËHILLIN | RAJONI

Tafani: Po të ishte gjallë Adem Jashari, do ishte dënuar

Analisti Endri Tafani ka kritikuar ashpër vendimin e gjykatës lidhur me ish-pjesëtarët e UÇK-së. Tafani ka ngritur shqetësimin se UÇK-ja po trajtohet tashmë jo si...

23:04 | 16/09/2026

TEMA

Vendi
Rajoni
Bota
Video

SHËRBIME

Live
Lajmi fundit
Na ndiqni
Euronews Radio
Për persona me aftësi të kufizuara

KOMPANIA

Rreth Euronews
Kushtet e përdorimit
Politika e cookie
Kontakttoni

Punësimi

Follow Euronews on all platforms: